



DORACAK

mbi Konventën e Stambollit
dhe Ligjin për parandalimin
dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj
grave dhe dhunës në familje

udhërrëfyes zbatimi
për nëpunës



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Granti është siguruar nga Fondacioni Ballkanik për Demokraci, një projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë çdoherë pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Fondacionit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës apo partnerëve të tyre.

DORACAK

mbi Konventën e Stambollit
dhe Ligjin për parandalimin
dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj
grave dhe dhunës në familje

udhërrëfyes zbatimi
për nëpunës

P Ë R M B A J T J A

PJESA I

KONVENTA E STAMBOLLIT 4

PJESA II

STANDARDE TË TJERA NDËRKOMBËTARE..... 15

PJESA III

**LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN
NGA DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE 19**

Pjesa I

KONVENTA E STAMBOLLIT

Rreth Konventës së Stambollit

Konventa e Këshillit të Evropës (KE) për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje u miratua nga Komiteti i Ministrave të KE-së më 7 prill 2011. Më 11 maj 2011 ishte zyrtarisht e hapur për firmosje, kurse pas ratifikimit nga 10 vendet, ajo hyri në fuqi më 1 gusht 2014.

Për një mbrojtje të plotë në të gjitha fushat e trajtimit të viktimave, Konventa e Stambollit:

- integron parimet e të drejtave të njeriut;
- parashikon forma të veçanta të veprave penale (dhuna ndaj grave dhe vajzave);
- ofron udhëzime të qarta për ndërhyrjet e nevojshme në një kontekst kombëtar;
- vendos një mekanizëm për zbatim - Komiteti GREVIO.

Dispozitat e Konventës janë hartuar bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

KS dhe Republika e Maqedonisë së Veriut

Maqedonia e nënshkroi Konventën më 8 korrik 2011 dhe në dhjetor të vitit 2017 Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e Konventës së KE-së për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.¹ Konventa u ratifikua me depozitimin e instrumentit të ratifikimit, i cili u dorëzua më 23 mars 2018, **kurse filloi të zbatohet më 1 korrik 2018.**

1 Ligji për Ratifikimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (dhjetor, 2017). Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 198/2017.

Parimet kryesore të Konventës së Stambollit

Vëmendja e duhur (Due diligence)

Neni 5 i Konventës përcakton detyrimet e shtetit dhe parimin e kujdesit/vëmendjes të duhur. Sipas këtij parimi, shtetet anëtare janë të detyruara të përmbahen nga pjesëmarrja në çdo akt të dhunës ndaj grave dhe të sigurojnë që organet shtetërore, zyrtarët, nëpunësit, institucionet dhe aktorët e tjerë që veprojnë në emër të shtetit të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.

Shtetet, me kujdesin e duhur janë të detyruara të marrin masat e nevojshme legislative dhe masat e tjera për të parandaluar, hetuar, ndëshkuar dhe siguruar korrigjim për aktet e dhunës të kryera nga individë privatë, të cilat mbulohen nga Konventa.

Barazia gjinore dhe ndjeshmëria (sensibiliteti) gjinore

Konventa e Stambollit në vetë preambulën e saj përcakton se arritja de jure dhe de facto e barazisë ndërmjet grave dhe burrave është një element kyç në parandalimin e dhunës ndaj grave. Dhuna ndaj grave është një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të fuqisë midis grave dhe burrave, që ka çuar në dominimin dhe diskriminimin e grave nga burrat dhe në parandalimin e avancimit të plotë të grave. Konventa e njeh natyrën strukturore të dhunës ndaj grave si dhunë me bazë gjinore dhe se dhuna ndaj grave është një nga mekanizmat kryesorë shoqërorë me anë të të cilit ato vendosen në një pozitë të varur në raport me burrat.

Konventa identifikon se dhuna në familje prek në mënyrë disproporcionale gratë, por gjithashtu se edhe burrat mund të jenë viktimë të dhunës në familje.

Të gjitha dispozitat e Konventës, me përjashtim të neneve që kanë të bëjnë me gjykimin gjenital femëror dhe abortin e detyruar dhe sterilizimin e detyruar, përcaktohen në një gjuhë neutrale ndaj gjinisë.

Qasja e përqendruar te viktimat

Standardet e përfshira në Konventë synojnë drejtpërdrejt mbështetjen e viktimave në një mënyrë që të drejtat, nevojat dhe siguria e tyre të jenë kyçe në të gjitha fazat e reagimit, ndërhyrjes dhe mbështetjes.

Masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave zbatohen pa diskriminim në çfarëdo baze si për shembull gjinia, seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, bindjet poli-

tike ose të tjera, origjina kombëtare ose sociale, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, orientimi seksual, identiteti gjinor, statusi shëndetësor, aftësia e kufizuar, statusi martesor, statusi i migrantit ose refugjatit, mosha ose ndonjë status tjetër.

Përqendrimi te fëmijët si viktime dhe dëshmitarë të drejtpërdrejtë

Konventa identifikon që fëmijët janë viktime të dhunës në familje sa herë që dhuna ndodh në praninë e tyre. Fokusi i Konventës është te mbështetja e fëmijëve dëshmitarë të dhunës, ku vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet të drejtave dhe nevojave të tyre, veçanërisht detyrimi për kujdesin e duhur në rastet e marrjes së masave në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës.

Qasja e koordinuar institucionale dhe multisektoriale

Në rastet e marrjes së masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës, institucionet janë të detyruara të veprojnë në mënyrë të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse. Konventa parashikon një detyrim për të miratuar politika shtetërore efektive dhe gjithëpërfshirëse që zbatohen përmes bashkëpunimit efektiv ndërmjet të gjitha agjencive, institucioneve dhe organizatave përkatëse.

Konventa përcakton se shtetet duhet të njohin, inkurajojnë dhe mbështesin punën e organizatave joqeveritare dhe organizatave të shoqërisë civile të përfshira në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe i detyron ato të themelojnë bashkëpunim aktiv me organizatat në fjalë.

Objektivi i Konventës së Stambollit

Konventa e Stambollit bazohet në katër parime kryesore: (I) parandalim; (II) mbrojtje dhe mbështetje; (III) ndjekje/hetim dhe (IV) politika të integruara.

I. Parandalimi

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë të rrënjosura thellë në vlerat sociale dhe kulturore të shoqërive, si dhe në zakonet dhe traditat. Konventa u kërkon shteteve të përqendrohen në ndryshimin e kulturave dhe traditave ku aktet e dhunës ndaj grave dhe vajzave janë të justifikuar dhe legjitimuara. Kjo do të thotë se shtetet kanë nevojë të:

- të ndryshojnë qëndrimet, rolet gjinore dhe stereotipet që justifikojnë dhunën ndaj grave;
- zbatojnë rregullisht fushata për rritjen ndërgjegjes për format e ndryshme të dhunës ndaj grave dhe traumat që përjetojnë viktimat si pasojë e dhunës;
- të zhvillojnë trajnime për nëpunësit-profesionistët që punojnë drejtpërdrejt me viktimat;
- të përfshijnë çështjet në lidhje me barazinë sa i përket materialeve mësimore në të gjitha nivelet e procesit arsimor. Kjo do të thotë ndryshimin e teksteve dhe angazhim me kuadrin mësimdhënës për të përjashtuar stereotipet gjinore nga procesi i mësimdhënies;
- të bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare, mediat dhe sektorin privat për të arritur te publiku i gjerë.

II. Mbrojtja

Shtetet janë të detyruara të marrin masat e domosdoshme dhe të nevojshme legjislative ose masa të tjera për të mbrojtur të gjitha viktimat e çdo akti të mëtejshëm të dhunës dhe përsëritjen e saj. Për të arritur mbrojtje të menjëhershme, gjithëpërfshirëse dhe cilësore për viktimat, shtetet duhet:

- të përgjigjen në kohë dhe të sigurojnë mbrojtje adekuate dhe të menjëhershme;
- të sigurojnë standarde për vlerësimin efektiv të rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut, në mënyrë që të parandalohet viktimizimi i sërishëm i viktimave;
- në legjislacionin kombëtar të përfshijnë dispozita që do të rregullojnë masat e mbrojtjes emergjente dhe masat e sigurisë për ndalimin e afrimit.
- të themelojnë strehimore të mjaftueshme për viktimat, të cilat do të mbulonin disa rajone;
- të ofrojnë shërbime të përgjithshme që do të ofronin mbrojtje adekuate për të gjitha viktimat e dhunës në bazë gjinore;
- të sigurojnë linja telefonike SOS në dispozicion 24/7;
- të fusin në përdorim shërbime të specializuara për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës me bazë gjinore; veçanërisht në fushën e ofrimit të

kujdesit dhe mbrojtjes shëndetësore, si dhe këshillimit psikologjik dhe juridik;

- të themelojnë qendra të krizës për viktimat e dhunës seksuale dhe qendra për udhëzimin e viktimave të dhunës seksuale;
- t'u ofrojnë viktimave informacionin e duhur dhe në kohë mbi shërbimet mbështetëse dhe mjetet juridike të disponueshme, në gjuhën që ato kuptojnë.

III. Ndjekja/hetimi

Konventa e Stambollit parasheh format e mëposhtme të dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore:

- dhunën në familje
- dhunën fizike
- dhunën psikologjike
- përndjekjen
- dhunën seksuale, përfshi edhe dhunimin
- martesën e imponuar
- gjymtimin gjenital femëror
- abortimin e detyruar dhe sterilizimin e detyruar

Veprat penale të përcaktuara nga Konventa vlejnë pavarësisht natyrës së marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe autorit. Prandaj, shtetet:

- duhet të kriminalizojnë veprat e parashikuara penale në legjislacionin e brendshëm dhe, në përputhje me rrethanat, të ndëshkojnë autorët e dhunës ndaj grave;
- nuk duhet të pranojnë se kultura, zakonet, feja, tradita apo "nderi" janë një justifikim të çdo forme të kryer të dhunës;
- duhet të sigurojnë akses në masa të veçanta të mbrojtjes për viktimat gjatë hetimeve dhe procedurave gjyqësore;

- duhet të garantojnë që oficerët e policisë t'i përgjigjen menjëherë thirrjeve për ndihmë dhe të veprojnë në mënyrë adekuate.

IV. Politikat e integruara

Standardet e Konventës së Stambollit imponojnë nevojën për një përgjigje efektive ndaj të gjitha rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e cila nga ana tjetër nënkupton një veprim gjithëpërfshirës dhe të koordinuar të të gjithë aktorëve përkatës. Një përgjigje efektive varet nga veprimet specifike të ndërmarra nga organet qeveritare, organizatat joqeveritare të grave, si dhe parlamentet, komisionet dhe institucionet e tjera kombëtare, rajonale dhe lokale.

Shtetet janë të detyruara të themelojnë një ose më shumë organe zyrtare të cilat do të jenë përgjegjëse për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave.

Për të pasur një përgjigje të koordinuar në nivel qendror dhe lokal, është veçanërisht e rëndësishme që shtetet të mbledhin të dhëna të zbërthyera, të kryejnë sondazhe dhe të mbështesin kërkimet/hulumtimet në lidhje me dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore.

Format e dhunës ndaj grave (DhNG) ose dhuna me bazë gjinore (DhBGj)

Dhuna psikologjike

Çdo sjellje e qëllimshme që dëmton seriozisht integritetin mendor të një personi përmes përdorimit të detyrimit ose frikësimit.

Dhuna psikologjike përfshin kontrollimin e lëvizjeve dhe kontakteve të një gruaje, xhelozinë ose posesivitetin, si dhe

Dhuna psikologjike e ushtruar nga një partner intim është dukshëm më e zakonshme, ku 44% e grave konfirmojnë se kanë përjetuar të njëjtën gjë (43% e grave që kanë plotësuar pyetësin në gjuhën shqipe)²

2 Të dhënat nga Hulumtimi i OSBE-së për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, të disponueshme në: https://www.osce.org/files/f/documents/5/4/424409_0.pdf

7% oe grave ishin ndjekur fshehurazi (4% e grave shqipfolëse).

të gjitha sjelljet e tjera që i shkaktojnë një gruajë vuajtje emocionale ose psikologjike.

Format më të zakonshme të dhunës psikologjike janë: kontrollimi i lëvizjeve, ndalesa për të komunikuar me të afërmit dhe miqtë, akuzimi i viktimës për sjelljen e dhunshme të dhunuesit, kërcënimi për t'ia marrë fëmijët, etj.

Përndjekja

Çdo sjellje e qëllimshme e kërcënimeve të përsëritura të drejtuara ndaj një personi tjetër, duke i shkaktuar këtij personi frikën për sigurinë e tij/saj.

Përndjekja mund të ndodhë edhe pa kontakt fizik dhe zakonisht përfshin akte kërcënimi dhe ngacmimi; mund të ndodhë në zyrë ose në internet dhe mund të manifestohet edhe si aktivitete të vazhdueshme të ndjekjes së viktimave.

Dhuna fizike

Çdo kryerje me dashje e akteve të dhunës fizike ndaj një personi tjetër.

Dhuna seksuale, përfshi edhe dhunimin

Çdo sjellje e qëllimshme që përbën depërtim/penetrim vaginal, anal ose oral të natyrës seksuale me ndonjë pjesë të trupit ose objekt në trupin e një personi tjetër pa pëlqimin e tij; akte të tjera të natyrës seksuale me një person pa pëlqimin e tij/saj; nxitja e një personi tjetër për t'u përfshirë në akte të natyrës seksuale me një palë të tretë pa pëlqimin e tij.

14% e grave kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale që nga mosha 15 vjeçare nga një partner ose jopartner (7% e grave shqipfolëse, në krahasim me 16% e grave që flasin maqedonisht).

Konventa e Stambollit i kushton vëmendje të veçantë dhënies së pëlqimit për marrëdhënie sek-

suale dhe thekson se pëlqimi duhet të jepet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit, duke e vlerësuar në kontekstin e rrethanave shoqëruese. Me këto dispozita, Konventa përfshin edhe bashkëshortët/et aktualë/e dhe ato të mëparshëm/me.

Martesa e imponuar

Çdo detyrim apo imponim i qëllimshëm i një të rrituri ose fëmije për t'u martuar. Martesa e imponuar gjithashtu nënkupton joshjen e qëllimshme të një të rrituri ose një fëmije në territorin e një ane ose vendi të ndryshëm nga vendi në të cilin ata banojnë, me qëllim që t'i detyrojnë ata të martohen.

Gjymtimi gjenital

Çdo sjellje e qëllimshme që përbën prerje, infibulim ose çdo gjymtim tjetër, tërësisht ose pjesërisht, të buzës (labia majora), buzëve të vogla (labia minora) ose klitorisit të një gruaje ose vajze; detyrimi ose joshja e një gruaje për t'u përfshirë në ndonjë nga këto veprime/akte. Ky term përfshin gjithashtu inkurajimin, detyrimin ose joshjen e një vajze që të përfshihet në ndonjë nga veprimet/aktet e përmendura.

Aborti i imponuar

Çdo sjellje e qëllimshme që përfshin kryerjen e një aborti ndaj një gruaje pa pëlqimin e saj të informuar paraprak; kryerjen e një operacioni të një grua pa pëlqimin e saj paraprak të informuar, respektivisht të kuptuarit e procedurës qëllimi ose pasoja e së cilës është ndërprerja e aftësisë së saj për riprodhim natyral.

Ngacmimi seksual

Çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale me qëllim ose pasojë të cenojë dinjitetin e personit, veçanërisht kur krijohet një rrethanë frikësuese, armiqësore, poshtëruese, nënçmuese ose ofenduese.

Tre nga dhjetë (30%) gra kanë qenë të ngacmuara seksualisht në moshën e tyre 15 vjeç, dhe një nga dhjetë (10%) kishin thënë se ishin abuzuar seksualisht në 12 muajt para hulumtimit (9% dhe 4% e grave shqipfolëse).

Dhuna në familje

Përcakton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe/ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose amvisërisë, respektivisht që ndodhin midis bashkëshortëve ose partnerëve të mëparshëm ose aktual, pavarësisht nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtin vendbanim me viktimën ose jo.

Dhuna në familje është një nga format më të rënda dhe më të zakonshme të dhunës ndaj grave nga ana e partnerit intim. Dhuna në familje i referohet dhunës nga partneri intim ndërmjet partnerëve aktualë ose të mëparshëm, si dhe dhunës ndër gjeneratash, siç për shembull dhuna midis prindërve dhe fëmijëve.

Dhuna në familje i referohet gjithashtu dhunës që ndodh midis partnerëve aktualë ose ish-partnerëve intimë. Në këtë rast, nuk është e domosdoshme ata të ndajnë të njëjtin vend banimi. Prandaj, kur institucionet merren me këtë formë të DhNG-së, është shumë e rëndësishme që të mos kërkojnë prova të bashkëjetesës së detyrueshme apo një marrëdhënie aktuale për të konstatuar prezencën e dhunës në familje.

Dinamika e abuzimit në kontekstin e dhunës në familje ndjek një cikël të quajtur përdorimi i pushtetit/fuqisë dhe kontrollit. Sjellja e dhunshme mund të manifestohet nëpërmjet:

- kufizimit të qasjes në financa
- kërcënimit se do t'ia marrin fëmijët
- ushtrimit të frikës dhe kontrollimit emocional
- izolimit të gruas nga të afërmit dhe familjarët e saj
- akuzimit të viktimës se është ajo fajtoreshë për sjelljen e dhunuesit

Të gjitha këto veprime justifikojnë sjelljen e pushtetit dhe kontrollit mbi viktimën.

Fëmijët dhe dhuna në familje

Konventa e Stambollit përcakton qartë dhe pa mëdyshje se fëmijët janë viktimat të drejtpërdrejta të dhunës. Ata trajtohen si viktimat edhe në rastet kur janë dëshmitarë të dhunës ose kur vetë janë subjekt i çfarëdo forme të dhunës.

Konventa përfshin standarde të veçanta për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve dëshmitarë. Neni 26 i detyron shtetet të marrin parasysh të drejtat dhe nevojat e fëmijëve që kanë qenë dëshmitarë të të gjitha formave të dhunës që mbulojnë dispozitat e Konventës. Masat mbrojtëse duhet të përfshijnë këshillimin psikosocial, veçanërisht duke marrë në konsideratë interesin më të mirë për fëmijën.

Neni 31 përcakton për herë të parë mënyrën se si përcaktohen të drejtat e kujdestarisë dhe vizitës së fëmijëve nga dhunuesit në rastet kur ka dhunë ndaj grave ose dhunë në familje. Konventa kërkon që shteti të marrë masat e duhura legjislative ose masa të tjera për të siguruar që çdo e drejtë për të vizituar ose për të ushtruar kujdestarinë e fëmijëve të mos rrezikojë të drejtat dhe sigurinë e viktimës ose fëmijëve. Nga kjo rrjedh se shtetet në asnjë rast nuk duhet të lejojnë që fëmijët t'u ekspozohen kontaktit të lirshëm me babain dhunues dhe as nuk duhet të merret parasysh e drejta për t'ia dhënë kujdestarinë e fëmijës së abuzuar një babai dhunues ose për ta vizituar fëmijën pa mbikëqyrje.

Pasojat e dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore

Dhuna ndaj grave ka pasoja afatgjata psikologjike dhe fizike, të cilat reflektohen jo vetëm te to, por edhe te fëmijët në cilësinë e viktimës dhe dëshmitarit të drejtpërdrejtë të dhunës. E gjithë kjo ndikon te familjet dhe komunitetet ku ata veprojnë. Dhuna dëmton shëndetin mendor dhe fizik të viktimës, ka pasoja afatgjata për mirëqenien e fëmijëve, mund të çojë në humbjen e punës, në pasiguri, madje mund të çojë në faktin e të qenit e pastrehë.

Pasojat fizike të dhunës mund të jenë mavijosje, prerje, fraktura dhe lëndime të tjera (të rënda) trupore. Në situata ekstreme, dhuna fizike mund të përfundojë në femicid.

Femicidi është vrasja e një gruaje vetëm sepse ajo është grua. Femicidi është forma më e rëndë e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe është një nga shkaqet kryesore të vdekjes së hershme të grave në mbarë botën. Femicidi më së shpeshti shkaktohet nga një person me të cilin viktimja është në një marrëdhënie intime. Në vendin tonë, femicidet janë më së shpeshti rezultat i mos raportimit të dhunës në familje apo veprimet të papërshtatshëm të institucioneve përkatëse.

Pasojat psikologjike zakonisht janë afatgjata dhe manifestohen si frikë, fobi, turp, ndjenjë faji, ankth, pamundësi për të komunikuar me mjedisin, mbyllje në vetvete etj.

Pasojat afatgjata më së shpeshti reflektojnë dhe ndikojnë në jetën sociale, ekonomike, fizike dhe psikologjike të viktimës. Një shembull i tillë janë viktimat që janë ekonomikisht të varura nga dhunuesit e tyre dhe shpesh nuk mund të menaxhojnë buxhetin e tyre në mënyrë të pavarur, të marrin personalisht vendime, kurse ndonjëherë ndodh që të mbeten edhe të papuna.

Viktimat e abuzimit seksual kryesisht përballen me pasoja psikologjike afatgjata siç janë ankthi, vetëbesimi i ulët dhe ndjenja e fajit.

Pjesa II

STANDARDE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

— **Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg (GjEDNj)** —

Konventa e Stambollit është rezultat i praktikës së pasur gjyqësore që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg ka zhvilluar në dekadat e fundit, e cila ka të bëjë me trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Juridiksionin e saj për zgjidhjen e rasteve nga sfera e dhunës ndaj grave, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e bazon në dispozitat e mëposhtme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj):

- e drejta e jetës (neni 2)
- ndalimi i torturës (neni 3)
- e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare (neni 8)
- ndalimi i diskriminimit (neni 14)

— **Standardet e Bashkimit Evropian** —

Barazia midis burrave dhe grave është një nga parimet themelore të Bashkimit Evropian. Neni 2 i Traktatit themelues të BE-së i referohet të drejtave themelore të njeriut, mosdiskriminimit dhe parimit të barazisë midis burrave dhe grave si bazë për krijimin dhe ekzistencën e Bashkimit.

Përveç Traktatit për themelimin e Bashkimit, disa rregullore dhe direktiva janë të rëndësishme për luftimin e dhunës ndaj

Konventën e Stambollit BE-ja e ka nënshkruar në maj të vitit 2017, duke kërkuar t'u dërgojë një sinjal të fortë shteteve anëtare për të bërë të njëjtën gjë në nivel kombëtar

grave dhe ato fokusohen në mbrojtjen e viktimave, zbatimin ndërkuftar të masave të përkohshme të mbrojtjes dhe lloje të tjera të bashkëpunimit ndërkuftar midis vendeve anëtare:

- Direktiva 2011/99/BE për Urdhrin Evropian për Mbrojtje³ është dokumenti i parë i rëndësishëm që ka për qëllim mbrojtjen e viktimave të krimit, duke përfshirë viktimat e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht ato që janë subjekt i dhunës në familje ose përndjekjes në një mënyrë që u jep atyre të drejtën për mbrojtje të zgjatur në një vend tjetër anëtar të BE-së.
- Direktiva 2012/29/BE për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të veprave penale⁴ përcakton standardet e Bashkimit në lidhje me të drejtat e viktimave të veprave penale dhe mbështetjen e tyre, duke përfshirë edhe viktimat e dhunës me bazë gjinore. Direktiva thekson qartë se në rastet e trajtimit të viktimave të veprave penale, institucionet duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë që ta bëjnë këtë në mënyrë të tillë që të marrin mbështetje dhe që të gjitha viktimat, përfshirë viktimat e terrorizmit, të njihen.
- Rregullorja e BE-së Nr. 606/20135 plotëson Direktivën 2012/29/BE dhe trajton masat e mbrojtjes që janë pjesë e legjislacionit civil të vendeve anëtare. Synimi i kësaj rregullore është të krijojë një procedurë të shpejtë dhe të thjeshtë për zbatimin e masave të përkohshme të mbrojtjes përtej kufirit ndërmjet vendeve anëtare. Në këtë mënyrë mbrohen edhe viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Standarde të tjera ndërkombëtare

Në nivel ndërkombëtar, dhuna ndaj grave ishte njohur si diskriminim dhe shkelje e të drejtave të njeriut në fillim të viteve 1990, madje në disa dokumente:

- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Protokolli i saj Fakultativ⁶ (1979);
- Deklarata e OKB-së për eliminimin e dhunës ndaj grave⁷ (1993);

3 <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2011:101:0001:0011:EN:PDF>

4 <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2012:315:0057:0073:EN:PDF>

5 <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2013:181:0004:0012:en:PDF>

6 <http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/priracnik.pdf>

7 <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ViolenceAgainstWomen.aspx>

- Konventa Ndër-Amerikane për Parandalimin, Luftimin dhe Çrrenjosjen e dhunës ndaj grave⁸ (1994);
- Deklarata e Pekinit (1995);
- Rekomandimi (2002) i Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare për mbrojtjen e grave nga dhuna⁹;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje - Konventa e Stambollit (2011).

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) dhe Protokollin e saj Fakultativ 1979

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave është dokumenti i parë ligjërish në botë që rregullon çështjet e të drejtave të grave. Ajo ishte miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1979. Ajo përbëhet nga një preambulë dhe 30 nene që përcaktojnë standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të grave, përkatësisht të drejtat civile dhe sociale, statusin ligjor të gruas, të drejtat riprodhuese dhe ndikimin e faktorëve kulturorë në marrëdhëniet gjinore.

Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 i Komisionit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Në tekstin e tij origjinal, Komiteti CEDAW nuk e rregullonte në mënyrë eksplicite çështjen e dhunës ndaj grave, por kjo ndryshoi në vitin 1992 kur u miratua Rekomandimi i Përgjithshëm 19. Komiteti CEDAW në këtë Rekomandim ka vendosur qartë lidhjen ndërmjet diskriminimit, dhunës me bazë gjinore dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Neni 7 i Rekomandimit thotë se dhuna me bazë gjinore është një formë diskriminimi që kufizon ushtrimin e plotë të të drejtave të njeriut nga gratë, përkatësisht: të drejtën për jetë dhe të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit çnjerëzor, të drejtën për mbrojtje të barabartë në përputhje me normat humanitare në rastet e konflikteve të brendshme apo të jashtme, e drejta për siguri, e drejta për të krijuar familje, e drejta për akses në kujdesin shëndetësor dhe e drejta për akses të barabartë në tregun e punës.

8 <https://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-61.html>

9 Committee of Ministers, Recommendation Rec (2002)5 on the Protection of women against violence (30 April 2002).

Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 i Komisionit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 19 u plotësua në korrik të vitit 2017 me një rekomandim të ri nr. 35. Ky rekomandim përcaktoi se dhuna ndaj grave ndodh në të gjitha fushat e ndërveprimit njerëzor: në komunitete, në familje, në vende publike, në vendin e punës, politikë, sport, objektet shëndetësore, institucionet arsimore si dhe në hapësirën mediatike, që është interneti dhe sfera digjitale. Rekomandimi i përgjithshëm, ngjashëm Konventa e Stambollit, thekson nevojën për vendosjen e masave efektive për parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen penale dhe ndëshkimin, kompensimin si dhe koordinimin, monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave.

Rekomandimi i përgjithshëm nr. 33 për qasjen e grave në drejtësi i Komisionit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 33 trajton vendosjen e standardeve për aksesin me ndjeshmëri gjinore në drejtësi. Ky Rekomandim rregullon çështjet që kanë të bëjnë me: mbrojtjen ligjore, aksesueshmërinë, disponueshmërinë, cilësinë e mirë, sigurimin e mekanizmave juridikë dhe llogaridhënien e sistemeve të drejtësisë, ligjet, procedurat dhe praktikat diskriminuese, stereotipet dhe paragjykimet gjinore në sistemin e drejtësisë dhe rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve, nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimit për ndikimin e stereotipeve, edukimit mbi perspektivën gjinore dhe ndërgjegjësimi përmes shoqërisë civile, medias dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit.

Rekomandimi i përgjithshëm nr. 33 është veçanërisht i rëndësishëm për mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore, sepse identifikon 6 komponentë të ndërlidhur që ofrojnë akses në drejtësi për gratë viktime të dhunës me bazë gjinore: (1) aksesueshmërinë (2) disponueshmërinë (3) cilësinë e mirë (4) përgjegjësinë (5) mekanizmat juridikë dhe (6) ndihmën juridike falas.

Pjesa III

**LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE
MBROJTJEN NGA DHUNA NDAJ GRAVE
DHE DHUNA NË FAMILJE**

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje (2021) e përkufizon dhunën në familje si ngacmim, fyerje, rrezikim i sigurisë, lëndim trupor, dhunë seksuale ose ndonjë dhunë tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike që shkakton ndjenjën e pasigurisë, rrezikimit ose frikës, duke përfshirë kërcënimet për veprime të tilla, ndaj bashkëshortit/es, prindërve ose fëmijëve ose personave të tjerë që jetojnë në një bashkim martesor ose jashtëmartesor ose familje të përbashkët, si dhe ndaj një bashkëshorti/e aktual/e ose të mëparshëm, partneri jashtëmartesor ose personave që kanë një fëmijë të përbashkët ose janë në marrëdhënie të ngushta personale, pavarësisht nëse dhunuesi ndan apo ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

Ky ligj përfshin gjithashtu përkufizimet e dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore:

- „Dhuna ndaj grave“ është një shkelje e të drejtave të njeriut, diskriminim ndaj grave dhe i referohet të gjitha akteve të dhunës me bazë gjinore që çojnë në ose ka të ngjarë të çojnë në dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënimet dhe frikësimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për akte të tilla, zhvatje, kufizim arbitrar dhe/ose heqje lirie, qoftë në jetën publike apo private.
- „Dhunë me bazë gjinore ndaj grave“ është dhuna e drejtuar ndaj një gruaje për shkak se ajo është grua ose që e prek atë në mënyrë disproporcionale. Dhuna me bazë gjinore ndaj grave mbulon shkaqet dhe pasojat e ekuilibrit të pabarabartë të pushtetit midis grave dhe burrave si rezultat i një problemi shoqëror, e jo si individual. Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave dhe vajzave konsiderohen gjithashtu si forma të dhunës me bazë gjinore.

Qasja e përqendruar te viktimave dhe respektimi i të drejtave të njeriut

Sipas Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, organet shtetërore kanë obligim (due diligence) që të parandalojnë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje për të cilat ato kanë përgjegjësi të dorës së parë.

Neni 4: Autoritetet shtetërore, personat juridikë me autorizim publik, zyrtarët, nëpunësit dhe aktorët e tjerë që veprojnë në emër të shtetit, kanë detyrimin të përmbahen nga pjesëmarrja në akte dhune dhe të marrin të gjitha masat dhe aktivitetet për të parandaluar çdo veprim të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, duke përfshirë dhunën në familje.

Fajësimi i viktimave dhe diskriminimi i tyre nga institucionet shpesh i pengon viktimat të raportojnë dhunën dhe të kërkojnë ndihmën përkatëse. Nëse institucionet u kushtojnë më shumë vëmendje viktimave të dhunës me bazë gjinore, kjo do t'i forcojë ato dhe do të rrisë besimin e tyre në sistem. Në këtë mënyrë do të shmanget viktimizimi i sërishëm i grave dhe vajzave.

Format e dhunës ndaj grave dhe vajzave

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje ndjek standardet e Konventës së Stambollit kur bëhet fjalë për format e dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore dhe si i tillë parashikon format e mëposhtme:

- dhunën fizike
- dhunën psikologjike
- përndjekjen
- dhunën ekonomike

- dhunën seksuale dhe dhunimin
- martesën e imponuar
- gjymtimin gjenital femëror
- abortin e imponuar dhe sterilizimin e imponuar
- tregtimin e grave

Ligji përcakton gjithashtu dy forma të tjera të dhunës ndaj grave që nuk përfshihen në Konventën e Stambollit. Ato janë:

- kontrolli shtrëngues mbi gratë që është abuzim me pushtetin, përdorim i kërcënimeve, forcës ose formave të tjera të detyrimit, mashtrimit ose keqinterpretimit me qëllim që të kontrollohet sjellja dhe jeta e grave; dhe
- ngacmimi seksual në internet, i cili është një akt i padëshiruar verbal, joverbal ose akt tjetër i natyrës seksuale, që ka për qëllim ose pasojë cenimin e dinjitetit ose krijimin e një mjedisi, qasjeje ose praktike kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimi.

Pengesat në raportimin e dhunës nga viktimat

Pengesat për raportimin e dhunës nga viktimat janë rezultat i normave socio-kulturore, fuqisë ekonomike të gruas, pengesave ligjore dhe gjendjes psiko-sociale të grave.

Pengesat socio-kulturore për raportimin e dhunës lidhen me mbështetjen e viktimës nga familja dhe miqtë, por edhe me mënyrën se si komuniteti dhe/ose feja e interpreton këtë çështje. Arsyet ekonomike për mos raportimin e dhunës janë më së shpeshti varësia ekonomike e grave, mungesa e burimeve dhe të tjera.

Për të qenë në gjendje të raportojnë dhunën, viktimat duhet të kenë:

- qasja në informacion në lidhje me shërbimet e disponueshme për ta
- qasje në shërbimet e rikuperimit

- qasje dhe të drejtë kompensimi të dëmit
- urgjencë në trajtimin e rasteve të tyre
- masa mbrojtëse
- aksesueshmëria duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të përshtatet me nevojat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara

Viktimat shpesh nuk kanë akses në informacion për shkak të:

- mungesës së shërbimeve adekuate
- ndërgjegjësimit të ulët për problemin
- diskriminimit nga vetë institucionet, veçanërisht në rastet komplekse me diskriminim të shumëfishtë
- referimit të vazhdueshëm nga një institucion në tjetrin (sistem i referimit dhe mbështetjes i vendosur në mënyrë jo të duhur)
- frikës nga proceset gjyqësore
- mungesës së informacionit për shkak të paaksesueshmërisë së sistemit ndaj nevojave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara

Parimet themelore të veprimit

Çdo nëpunës apo çdo person që vepron në rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës seksuale duhet të ndjekë parimet bazë të përcaktuara në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje.

Mosdiskriminimi

Sipas **nenit 5** të ligjit, dhuna me bazë gjinore ndaj grave është diskriminim ndaj grave që i kufizon ato nga ushtrimi i të drejtave dhe lirive në baza të barabarta me burrat.

Masat, aktivitetet dhe shërbimet e këtij ligji ndërmerren me qëllim zbatimin e parimit të barazisë, eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore, parandalimin

dhe mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit ndaj grave viktime të dhunës me bazë gjinore dhe viktime të dhunës në familje.

Masat, aktivitetet dhe shërbimet për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna me bazë gjinore dhe viktime të dhunës në familje zbatohen pa diskriminim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës, kombësisë ose përkatësisë etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësia e një grupi të marginalizuar, gjuha, shtetësia, origjina sociale, arsimimi, feja ose besimi, besimi politik, besimi tjetër, paaftësia, mosha, statusi martesor ose familjar, statusi pasuror, gjendja shëndetësore, statusi personal dhe statusi shoqëror ose ndonjë bazë tjetër.

Parimi i ndalimit të viktimizimit

Neni 6 ndalon çdo veprim me të cilin viktimat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës seksuale do të viktimizoheshin në çdo fazë të procedurës për mbrojtjen e tyre ose mbrojtjen e fëmijëve të tyre.

Gratë e cënueshme/të pambrojtura

Neni 7 përcakton se disa kategori të grave mund të jenë në disavantazh dhe të jenë më të prekshme ndaj formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale. Për shembull, gratë shtatzëna, gratë me fëmijë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, anëtarët e komuniteteve joshumicë, nënat e vetme, gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga zonat rurale, gratë që përdorin drogë, punonjëset e seksit, migrantët, refugjatët, azilkërkuarit, gratë pa shtetësi, lezbiket, biseksualët dhe transgjitorët, gratë që jetojnë me HIV, të pastrehat, gratë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore, gra të moshuara, gra të pasigurta materialisht dhe të tjerë.

Parimi i përshtatjes përkatëse

Ligji parashikon që çdo masë, aktivitet ose shërbim i ofruar për viktimat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës seksuale duhet të përshtatet në mënyrë adekuate me nevojat specifike të grave me aftësi të kufizuara.

Parimi i politikave të përgjegjshme gjinore

Të gjitha masat, aktivitetet dhe shërbimet për parandalimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës seksuale duhet të jenë të përgjegjshme në aspektin gjinor dhe të njohin karakteristikat dhe dallimet që dalin nga rolet gjinor

nore të grave dhe burrave. Politikat e përgjegjshme gjinore përfshijnë perspektivën gjinore si kriter që integrohet në të gjitha fazat e procesit të politikëbërjes, vlerësimit të situatës, zbatimit dhe vlerësimit të politikave që dalin nga ky ligj.

Parimi i fuqizimit të grave që përjetojnë dhunë

Të gjitha aktivitetet dhe masat për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës seksuale duhet të sigurohen në atë mënyrë që të mundësojnë fuqizimin e potencialit dhe kapaciteteve të viktimës. Viktimat marrin pjesë në të gjitha vendimet për mbrojtjen e tyre. Pa pëlqimin e viktimës, institucionet nuk mund të marrin masa për mbrojtje, me përjashtim të rasteve kur ka rrezik të menjëhershëm për jetën dhe trupin e saj.

Institucionet kompetente

Institucione kompetente për zbatimin e masave për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës seksuale janë të gjitha organet e administratës shtetërore, gjykatat, prokuroria publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe personat e tjerë juridikë. Të gjithë ata që punojnë me rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës seksuale duhet të kenë trajnim të përgjithshëm dhe të specializuar dhe të kuptojnë punën me këto forma dhune. Të gjitha institucionet që punojnë në këtë fushë janë të detyruara të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në bazë të një protokollit të vendosur pune, sepse dhuna me bazë gjinore ndaj grave dhe dhuna seksuale mund të parandalohen vetëm përmes një reagimi të përbashkët të të gjithë aktorëve në sistemin e mbrojtjes dhe ndjekjes.

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje përcakton saktësisht obligimet për zbatimin e masave dhe aktiviteteteve për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës seksuale të këtyre institucioneve:

- Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Grupit Koordinues Kombëtar për Zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje

- Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale
- Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Ministrisë së Shëndetësisë
- Ministrisë së Drejtësisë
- Njësive të vetëqeverisjes lokale
- Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizive
- Akademisë së Gjykatësve dhe prokurorëve publikë
- Shoqatave të qytetarëve
- Sindikatave

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje përcakton mënyrën e raportimit të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje nga publiku dhe nga nëpunësit.

Çdo qytetar që ka dijeni për ekzistimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është i obliguar të raportojë në stacionin policor, qendrën për punë sociale, prokurorinë publike, shoqatën ose linjën SOS (neni 40).

Personi përgjegjës dhe drejtuesi i institucionit, të cilët kryejnë veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, punësimit, punëve të brendshme, shëndetësisë dhe arsimit, janë të detyruar të denoncojnë në një stacion policie ose në qendër për çështje sociale, çdo dhunë ndaj grave dhe dhunë në familje. Gjithashtu, çdo person përgjegjës dhe drejtues në një subjekt juridik është i detyruar të raportojë në stacionin policor ose në qendër për punë sociale, informacionin për ekzistimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (neni 41).

Gjithashtu, ky ligj përcakton *detyrimin e policisë, qendrave të punës sociale, prokurorëve dhe gjyqtarëve për të vlerësuar rrezikun për jetën dhe integritetin fizik të viktimës, për të vlerësuar rrezikun e përsëritjes së dhunës për të menaxhuar rrezikun dhe për të ofruar masa për ndihmë të koordinuar dhe mbrojtje të viktimës (neni 50)*. Në kuadër të vlerësimit të rrezikut, ndërmerren veprime të menjëhershme brenda gjashtë orëve të para të raportimit. Është paraparë edhe e drejta për ta shoqëruar viktimën gjatë gjithë procedurës për të ofruar mbështetje të plotë dhe për të parandaluar riviktimizimin e viktimës. Më shpesh, femra-përf-

aqësuese të organizatave joqeveritare paraqiten si shoqëruese të viktimave të dhunës me bazë gjinore, sepse kanë përvojë shumëvjeçare në procese të tilla. Qëllimi i shoqërimit është të mbështesë viktimën në proces. Viktima mund të zgjedhë të shoqërohet nga ndonjë i rritur, përveç autorit të dhunës në familje në procedurë (neni 43).

Vlerësimi i rrezikut bëhet me ndihmën e formularëve të përcaktuar posaçërisht për vlerësimin e rrezikut, në çdo rast specifik. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Punëve të Brendshme kanë rregullore të veçanta që përshkruajnë mënyrën e vlerësimit të rrezikut për jetën dhe integritetin fizik të viktimës dhe rrezikun e përsëritjes së dhunës; menaxhimin e duhur të rrezikut; formularin e kallëzimit policor ose raportin e qendrës për çështje sociale dhe formularin e propozimit për shqiptimin e masës/masave përkatëse të përkohshme.

Ligji parashikon gjithashtu mbrojtje nga viktimizimi i sërishëm duke vendosur standarde të veçanta për parandalimin e riviktimizimit gjatë gjithë procedurës. Sipas kësaj, institucionet janë të obliguara që:

- të mbrojnë identitetin dhe të dhënat personale të viktimës
- të marrin një deklaratë-dëshmi në vendin e raportimit
- të regjistrohet me video dhe audio deklarata/dëshmia e viktimës në një stacion policor ose në zyrën e prokurorisë
- biseda të zhvillohet në dhoma të veçanta të përshtatura për biseda me viktimat;
- të kufizojnë përballjen me personin e denoncuar;

- të kufizohet dhënia e dëshmisë në maksimum dy herë gjatë procedurës dhe të merren masa të tjera që do të mbrojnë integritetin e viktimës (neni 68)

Me qëllim të ndalimit të dhunës, eliminimit të pasojave dhe ndëshkimit efektiv të autorëve, gjykata mund të vendosë ndaj dhunuesit këto masa të përkohshme:

1. Ndalimi i kërcënimit për të ushtruar dhunë;
2. Ndalim torturimi, ngacmimi, telefonimi, kontaktimi;
3. Ndalimi i afrimit në një distancë më të vogël se 100 metra nga vendbanimi, shkolla, vendi i punës ose vendi i caktuar që viktima viziton rregullisht;
4. Largimi nga shtëpia pavarësisht nga pronësia, në kohëzgjatje prej 10 deri në 30 ditë;
5. Ndalimi i posedimit të armës së zjarrit ose armëve të tjera ose konfiskimit të saj;
6. Domosdoshmërisht t'i kthejë sendet e nevojshme për të përmbushur nevojat e përditshme të viktimës dhe familjes;
7. Mbështetja ligjore e detyrueshme për familjen;
8. Domosdoshmërisht të merrin pjesë në një qendër këshillimi për autorët e dhunës ndaj grave - ose dhunës në familje;
9. Trajtimi i detyrueshëm i kryesit, nëse ai abuzon me alkoolin, drogën dhe substancat e tjera psikotrope ose ka sëmundje mendore.;
10. Kryesi duhet të rimburojë shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara si pasojë e dhunës dhe
11. Çdo masë tjetër që gjykata e çmon të nevojshme për sigurinë dhe mirëqenien e viktimës dhe anëtarëve të tjerë të familjes (neni 58)

Masat 1 deri 5 kryhen nga Ministria e Punëve të Brendshme ndërsa masa nga pika 9 është në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë. Këto masa të përkohshme mund të vendosen për një periudhë prej të paktën tre

muajsh, dhe maksimumi deri në një vit me mundësi vazhdimi nëse ende ekziston rreziku i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale.

Masën intervenuese për mbrojtje të menjëhershme të viktimës me qëllim eliminimin e rrezikut të menjëhershëm dhe serioz për jetën, e përcaktuar në nenin 57 të Ligjit, propozohet nga punonjësi policor nga stacioni policor kompetent pa pëlqimin e viktimës.

Propozimin për shqiptimin e masave të përkohshme të mbrojtjes nga neni 58 i ligjit, viktimja e dorëzon në gjykatën kompetente drejtpërdrejt ose përmes qendrës për punë sociale me kërkesë të saj. Qendra kompetente për punë sociale propozim për shqiptimin e masës së përkohshme të mbrojtjes mund t'i dorëzojë gjykatës kompetente vetëm me pëlqimin e viktimës.

Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale është e obliguar të ndërmarrë këto masa urgjente:

- akomodimin emergjent të viktimave në Qendrën e Krizave deri në 48 orë,
- strehimin e përkohshëm,
- thirrjen e një ambulance dhe shoqërimit e viktimës,
- ofrimin e mbështetjes psiko-sociale,
- dorëzimin e kërkesës për caktimin e masave të përkohshme të mbrojtjes me pëlqimin e viktimës,
- kontaktimin e policisë dhe prokurorisë,
- informimin e viktimës për të drejtat dhe mbrojtjen e saj
- sigurimin e ndihmës së familjes për shkollimin e rregullt të fëmijëve,
- ofrimin e ndihmës dhe përfaqësimit juridik,
- referimin e viktimës drejt programeve për fuqizimin e saj ekonomik (neni 46).

Gjithashtu në rast rreziku të lartë dhe marrjen e masave urgjente mbrojtëse, si dhe kur viktima përdor shërbimet e qëndrimit të përkohshëm dhe jo më vonë se 12 orë nga marrja e kërkesës, merr vendim për dhënien e përkohshme të kujdestarisë për edukimin e fëmijëve prindit-viktimë.

Ministria e Punëve të Brendshme/Stacionet e policisë

Një fëmijë është viktimë kur pëson dhunë të drejtpërdrejtë, kur është i pranishëm në marrëdhënie të dhunshme ndërmjet anëtarëve të familjes ose kur jeton në një mjedis ku ka marrëdhënie të dhunshme.

Qendra për Punë Sociale mund të kufizojë ose ndalojë përkohësisht marrëdhëniet personale dhe kontaktet e drejtpërdrejta të fëmijës me prindin me të cilin ai/a jo nuk jeton së bashku, në rast se është në interes të fëmijës, ndërsa zgjasin rreziku dhe pasojat e dhunës së kryer (neni 47).

Është veçanërisht e rëndësishme që mbështetja e nënës dhe fëmijës të bëhet në një qasje të unifikuar, shumë-sektoriale për të shmangur riviktimizimin. Në raste të tilla, marrëdhënia e fëmijës me autorin e dhunës nuk duhet parë e veçuar nga dhuna që ushtrohet ndaj nënës, e cila shpeshherë shfaqet si praktikë në trajtimin e këtyre rasteve, si për shembull në përcaktimin e masave mbrojtëse.

Policia është e detyruar të ndjekë hapat e mëposhtëm:

- intervistoni viktimën dhe dhunuesin veçmas. Pyetni viktimën nëse ka një histori dhune;
- nëse ka fëmijë (mbi gjashtë vjeç) të pranishëm dhe ata nuk janë të traumatizuar, merrni një deklaratë prej tyre në prani të një inspektori për të mitur;

- dalloni se çfarë ka ndodhur në të vërtetë, çdo ndërmjetësim në raste të tilla është rreptësisht i ndaluar;
- dokumentoni çdo material, duke përfshirë gjendjen emocionale të viktimës;
- vini re ndonjë lëndim fizik për këdo që është i pranishëm;
- vini re sjelljen e dhunuesit;
- vini re çdo dëmtim të mjedisit;
- vëzhgoni me kujdes sjelljet e pazakonta si qetësia, ankthi, dhunuesi sheh viktimën, etj.;
- shikoni nëse ka mbetje të alkoolit dhe substancave të tjera kimike dhe psikotrope;
- informoni viktimën për hapat e mëtejshëm.
- ndaj me të kontaktet nga qendrat e strehimit dhe OJQ-të që mund ta ndihmojnë (mos e bëni këtë përpara dhunuesit);
- gjithmonë siguroni një përkthyes në rast se viktimë nuk e kupton gjuhën;
- siguroni gjithmonë një përkthyes të gjuhës së shenjave ose një metodë tjetër për të komunikuar me një viktimë me aftësi të kufizuara.

Deklarata/dëshmia e viktimave është shpesh prova më e rëndësishme në procedurë, prandaj është shumë e rëndësishme se si ajo do të merret. Deklarata është gjithashtu e rëndësishme për vlerësimin e rrezikut të recidivizmit dhe formësimin e planit të sigurisë.

Në procedurat lidhur me mbrojtjen e viktimave, gjykata nuk mund t'i referohet zgjidhjes reciproke të mosmarrëveshjes. Ndalohet çdo ndërmjetësim në këto raste! (neni 80)

Punonjësi i policisë, sa herë që ka denoncim të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, për të eliminuar rrezikun e menjëhershëm dhe serioz për jetën, është i detyruar të shkojë në vendngjarje dhe të përgatisë një ra-

port policor menjëherë dhe jo më vonë se 12 orë pas ndërhyrjes në vendin e ngjarjes. Punonjësi i policisë bën gjithmonë një vlerësim të rrezikut për një rrezik serioz për jetën e viktimës. Policia është e detyruar që viktimës t'i ofrojë kujdes shëndetësor urgjent, autorit t'i sekuestrojë përkohësisht armën dhe me kërkesë të viktimës ta shoqërojë deri në banesën e viktimës për të marrë sendet personale.

Në rast të rrezikut të menjëhershëm dhe serioz për jetën, zyrtari policor është i detyruar që menjëherë, e jo më vonë se 12 orë pas intervenimit të ngjarjes, ta njoftojë prokurorin publik kompetent. Zyrtari policor është i obliguar që gjykatës kompetente t'i paraqesë propozimin për shqiptimin e masës urgjente të mbrojtjes - largimin e kryesit nga shtëpia dhe ndalimin e afrimit në banesë dhe raport policor të përgatitur nga zyrtari policor. Për këtë masë zyrtari policor njofton qendrën kompetente për punë sociale (neni 49).

Institucionet shëndetësore dhe punonjësit shëndetësorë

Organizata shëndetësore dhe punonjësit shëndetësorë duhet ta mbrojnë menjëherë dhe pa pagesë viktimën duke siguruar (neni 51):

- ekzaminimin e lëndimit dhe trajtimin mjekësor;
- dokumentimin e lëndimeve dhe mbledhjen e provave të shkeljes së integritetit fizik dhe mendor;
- lëshimin e dokumentacionit mjekësor për lëndimet;
- informimin e viktimave për të drejtat dhe mbrojtjen e tyre.

Ekipi shumësektorial i ekspertëve

Sipas ligjit dhe standardeve të Konventës së Stambollit, sa herë që ka njohuri për rrezikimin e jetës dhe shëndetit të grave viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale, formohet një **ekip shumlësektorial ekspertësh që përgatit një plan sigurie për asistencë**. Ekipi i sigurisë formohet nga qendra kompetente për punë sociale nga ekspertë të Qendrës, stacionit policor kompetent dhe institucionit shëndetësor (neni 55). Ky ekip synon të sigurojë aktivitete të koordinuara në përmbushjen e nevojave të viktimës dhe fëmijëve të saj në

çdo rast. Ky ekip shumësektorial mund të kërkojë t'i bashkohen në punën e tij përfaqësues të shoqatave të specializuara në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës seksuale.

Puna shumësektoriale është e përcaktuar me protokoll të veçantë për bashkëpunim të ndërsjellë të institucioneve dhe shoqatave kompetente për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale dhe e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky protokoll rregullon llojet, mënyrën dhe përmbajtjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në marrjen e masave për parandalimin, luftimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës seksuale dhe marrjen e masave ligjore ndaj autorëve.

